



2511

130/1

REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E SHQYRTIMIT DHE MONITORIMIT TË LEJEVE MJEDISORE DHE VNM

Nr. 9278 / Prot.
//

Tiranë, më: 11.09. 2024

Lënda: Dërgohet Informacion.

Drejtuar: **Av. Dorian Matlija**
Qendra "Res Publica",
Bulevardi "Gjergj Fishta", Nd .24, H3, Ap 7, Tiranë.

Në përgjigje të suajës me Nr.130/24 Prot, regjistruar në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit me nr. 9278 Prot, datë 04.09.2024, lënda "Kërkesë për informacion", ju bëjmë me dije se:
Subjekti "PALUSHI" sh.p.k. është pajisur me Vendim për VNM Paraprakë, Nr. 1678 Prot, datë: 28.03.2019, për projektin "Ndërtimi i HEC Palushi ", me vendodhje në pellgun ujëmbledhës të përroit të Bicajt, degë e lumit Drin i Zi, Bashkia Kukës, Qarku Kukës.

Procedura është kryer në bazë të Ligjit Nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Shtojca II: Pika 3. Industria e energjisë /ë) Instalime për prodhimin e energjisë hidroelektrike dhe VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore" të ndryshuar.

Ky vendim mbështetet në Miratimin Paraprak nga MEI me Nr. 6748/3, datë 19.06.2018, "Për vazhdim procedure për ndërtimin e burimit të ri gjencruës të energjisë" për ndërtimin e Hidrocentralit "Palushi", në pellgun ujëmbledhës të përroit të Bicajt, degë e lumit Drin i Zi, Bashkia Kukës, Qarku Kukës.

Përpara dhënies së Vendimit nga Komisioni i Shqyrtimit të Kërkesave për VNM, subjektit i është kërkuar me shkrim nga AKM, që të kryhet dëgjesa me publikum.
Pas kësaj procedure është marrë vendimi sa më sipër.

Për sa më sipër, dhe në zbatim të Ligjit Nr. 10440, datë 7.7.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, Neni 20 pika 5. Nëse veprimtaria apo projekti, që i është nënshtruar procesit të VNM-së, nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të deklaratës apo vendimi për VNM-në, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para.

Afati i vlefshmërisë së aktit ka qënë deri në 29.03.2021.

Bashkëlidhur keni materialet e mëposhtme:

1. Vendimi i VNM Paraprake,
2. Relacioni i dëgjësës sjellë nga subjekti në aplikim,
3. Procesverbali i dëgjësës sjellë nga ARM Kukës

Duke Ju falënderuar,

DREJTORI I PËRGJITHSHËM



NR. PROT 10
21-01-2019

FORMULARI TIP I

Datë: 21.01.2019

**NJOFTIMI PËR INFORMIM NGA KËRKUESI PRANË AGJENCISË
KOMBËTARE TË MJEDISIT/ AGJENCISË RAJONALE TË MJEDISIT DHE NJQV
KU DO TË KETË VENDODHJEN INSTALIMI PËR APLIKIM.**

Bazuar në Ligjin Nr.10 431, datë 09.06.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", Ligjin
Nr.12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e
Ndikimit në Mjedis", VKM-së Nr. 247 datë 30.04.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të
kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen
mjedisore, njoftimi duhet të përmbajë këto të dhëna:

1. Të dhënat e ekstraktit të QKR-së: PALUSHI 1 SH.P K 1222200418
2. Adresën e vendodhjes së instalimit: PERROJ 1 BILAZIT
BASHKËIA KUKËS
3. Titulli i instalimit: NGJERTIMI I HËS. PALUSHI
4. Një përmbledhje joteknike të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis me CD;
5. Konsultimet ndërkufitare, kur kërkohet sipas legjislacionit në fuqi;
6. Adresën e AKM-së, ku publiku mund të dërgojë komentet dhe sugjerimet e tij, me
shkrim apo në formë elektronike, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e njoftimit.
info@akm.gov.al
Mbah përgjegjësi për dorëzimin e njoftimit pranë NJQV-së përkatëse në 20
CD/DVD


Kërkuesi/Përfiqësuesi / shoqërisë

(Shoqëria Palushi)

Nr. kontakti

06825 88 682

0683111105





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT KUKËS

NJOFTIM

MBESHJETUR NE LIGJIN NR 10 431 DATE 09.06.2011 "PER MBROJTJEN E MJEDISIT" , LIGJIT NR 10440 DATE 07.07.2011 I NDRYSHUAR "PER VLREESIMIN E NDIKIMIT NE MJEDIS " , LIGJIT NR.10448 DATE 14.07.2011"PER LEJET E MJEDISIT", VKM-SE NR 247 DATE 30.04.2014 "PER PERCAKTIMIN E RREGULLAVE , TE KERKESAVE E TE PROCEDURAVE PER INFORMIMIN DHE PERSHIRJEN E PUBLIKUT NE VENDIMARRJEN MJEDISORE", VKM NR 419 DATE 25.06.2014 "PËR MIRATIMIN E KËRKESAVE TË POSAÇME PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR LEJE MJEDISI TË TIPAVE A, B DHE C, PËR TRANSFERIMIN E LEJEVE NGA NJË SUBJEKT TE TJETRI, TË KUSHTEVE PËR LEJET RESPEKTIVE TË MJEDISIT, SI DHE RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR SHQYRTIMIN E TYRE NGA AUTORITETET KOMPETENTE DERI NË LËSHIMIN E KËTYRE LEJEVE NGA QKL-ja. KREU VI, PIKA 10/e, PIKA 11, VKM-SE NR 686 DATE 29.07.2015 "PER VNM-to "**JU NJOFTOJME SE:**

- 1- Shoqeria: "PALUSHI. shpk"
- 2- Administratori: MERIMAN PALUSHI
- 2-Lloji i instalimit/Veprimtaria NDERTIM FUNKSIONIM Hee PALUSHI.
- 3-Adresa e instalimit/Veprimtarise QARQU KUKËS, BASHKIA KUKËS, NjQV Bicaj , Perroi Bicajve; pran fshatit Bicaj & Nanngë; OBJEKTI "Hee PALUSHI".
- 4- Adresa e publikimit: <http://www.akm.gov.al/> (Publiku ne Vendimarrje Mjedisore)
<http://drmkukes.akm.gov.al/> (DRM-ja Kukës)
- 5- Data e takimit: E HANE, DATE 18.02.2019
- 6- Ora e takimit: ORA 11⁰⁰ ;
- 7- Vendi i takimit: PRANE VENDIT INSTALIMIT /fshati Bicaj/Nanngë



NJOFTIM DEGJESE ME PUBLIKUN, PALUSHI shpk

1 message

arm kukos <armkukos@gmail.com>

Wed, Feb 13, 2019 at 11:18 AM

To: manushaqe dogjani <manushaqe.dogjani@gmail.com>, info@lnca-al.org, eden@eden-al.org,

Erdona.Ramellari@shmpu.gov.al, bledar hasalami <bledarhasalami@gmail.com>

Cc: Edison Konomi <Edison.Konomi@akm.gov.al>

Pershendetje,

Degjesa me publikun per Subjektin " **PALUSHI shpk** me objekt: " **NDERTIM FUNKSIONIM HEC**

PALUSHI ", do te zhvillohet dite e HANE me dt 18.02.2019 Ora 11.00, PRANE VENDINSTAUMIT / Fshati Blcaj/Nange,

Nj.Q. V. Bicaj, Bashkia KUKES, Qarku KUKËS.

Bashkangjitor po ju dergojmë permbledhjen jo teknike per subjektin ne fjale, si dhe Njotfimin e Degjeses me Publikun.

Ju lutem konfirmoni marrjen e email-it.

Pune te mbare.

Shemsi SHAHU

Drejtor i DRM-se Kukës

Mobile:+355 68 34 78 612

email: Shemsi.Shahu@akm.gov.al

shemsi@shahu@yahoo.com

2 attachments

 Njoffim DP Palushi shpk HEC PALUSHI.pdf
285K

 HEC Palushi permbledhje-jo teknike.pdf
6426K



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT KUKËS

Nr. 52 Prot.

Kukës më 13.02.2019

Drejtuar:

Bashkia KUKËS

Adresa: Shteti "Skenderbeu"

Kukës

Lënda: Njoftim për degjese me publikum.

Bashkëlidhur po ju dërgojm Njoftimin për degjese me publikum për subjektin "PALUSHI shpk. me objekt NDERTIM FUNKSIONIM HEC PALUSHI. Gjithashtu gjeni CD me dokumentat për subjektin.

Faleminderit për mirëkuptimin e bashkëpunimin!

DREJTORI
SHËMSE SHAHU

FORMULAR TIP II

DËGJESA ME PUBLIKUN PËR VENDODHJEN E INSTALIMIT

NJOFTIM

Agjencia Kombëtare e Mjedisit/ ARM e deleguar, njofton se do të organizohet Dëgjesa publike/scënica dëgjimore ku ftohen të jenë pjesëmarrës dhe palët e interesuara, në lidhje me vendodhjen e aktivitetit para se kërkuesi të aplikojë për VNM të Thelluar.

- **LLOJI I INSTALIMIT:** *Ndërtim dhe funksionimi i Heq "PALUSHI"*
- **EMRIN E PERSONIT FIZIK/JURIDIK:** *"PALUSHI" Sh.p.k*
- **ADRESËN E VENDODHJES SË INSTALIMIT:** *Kulës, Kulës, N.Y.D.Y. Përroi Rëncejve,*
- **ADRESA ELEKTRONIKE E AKM-së:** *info@akm.gov.al*, ku publiku i interesuar dërgon komente dhe sugjerime, lidhur me zhvillimin e aktivitetit.
- **VENDI I TAKIMIT , TEL:** *Fromi vendit ku do të ndërtohet Godina e Heqit*
- **DATA DHE ORA E DËGJESËS:** *13-02-2018 ora 11⁰⁰*
- Mbaj përgjegjësi për dorëzimin e njoftimit pranë NJQV-së përkatëse në 20 kopje CD/DVD

Ftohen të marrin pjesë në këtë takim:

- Përfaqësues nga AKM / ARM
 - Përfaqësues nga NJQV
 - Përfaqësues nga OJF, OJQ
 - Përfaqësues nga shoqëria civile
 - Përfaqësues të bizneseve përreth
 - Përfaqësues nga media vizive dhe të shkruara lokale
- Banorë të zonës përreth

ZHVILLIMI I SEANCËS DËGJIMORE

Pjesëmarrësve në takim iu shpërndahet informacioni si më poshtë:

Vendi i zbatimit të projektit: Darku Hutes, Poshelina Hutes, N.R. X. Prizren, Prizren, Prizren.
Aktiviteti: Adhërtimi dhe funksionimi i Heç "PACUSHT"
Kapaciteti, teknologjia: Traktimi i energjisë elektrike dhe përdorimi i energjisë elektrike në Prizren. Kapaciteti i projektuar është = 1012 kW.
Lëndët e para, energjia, uji që do të përdoren: Rrëzë Gure, strukturë të përbërë nga beton armë si dhe tubacione çeliku dhe plumbi specifikë në funksion të projektit.
Kohëzgjatjen e punimeve dhe funksionimit: Koha e punimeve të ndërimit do të jetë 48 muaj.
Mbetjet që do të gjenerohen, lloji dhe sasia e tyre: Mbetje inertë që vijnë si rezultat i formimeve për ndërimit dhe veprime të tjerë dhe konsolidim të vendosur tubacioni i prerësor.
Ndikimet negative në shëndet e mjedis: Shkëmbime në ajër të plumbit gjatë punimeve të tubacioneve nga shpërndarja e energjisë elektrike në përdorim të tubacioneve të prerësorëve gjatë punimeve të ndërimit dhe funksionimit të projektit.
Masat që do të merren për reduktimin e tyre: - Përdorimi i tubacioneve të prerësorëve për uljen e plumbit. - Lapatë e tubacioneve të punimeve për uljen e plumbit. - Sistemi i inerteve. - Rehabilitimi i shtesë zonës ku shtrihen projektet.
Masat që do të merren për monitorimin e tyre: Monitorimi i varzësive të shtesë sipas legjislativës në fuqi.

Mbahen shënim si më poshtë:

- Mblatrat e takimit të shoqëruara me foto
- Emrat e pjesëmarrësve
- Problemet e ngritura nga të pranishmit, pyetje, komente, sugjerime dhe konkluzionet e arritura gjatë kësaj mbledhje
- I gjithë takimi zbardhet nga përfaqësuesi i shoqërisë dhe i bashkangjitet dosjes së aplikimit


Morën pjesë në Dëgjueshën me Publikun si më poshtë, shoqëruar dhe me foto:

Nr	Emër, mblemër, nënshkrimi	Institucioni, statusi	Nr. i kartës së identitetit	Largësia e banesës nga objekti (deklaruar nga banori)
1	[Redacted]	BANOR	[Redacted]	2 km
2	[Redacted]	BANOR	[Redacted]	2 km
3	[Redacted]	BANOR	[Redacted]	1 km
4	[Redacted]	BANOR	[Redacted]	1,5 km
5	[Redacted]	BANOR	[Redacted]	1,7 km
6	[Redacted]	BANOR	[Redacted]	2 km
7	[Redacted]	BANOR	[Redacted]	1 km
8	[Redacted]	BANOR	[Redacted]	1 km
9	[Redacted]	BANOR	[Redacted]	2 km
10	[Redacted]	BANOR	[Redacted]	2 km
11	[Redacted]	P.h. F. [Redacted]	[Redacted]	[Redacted]
12	[Redacted]			
13	[Redacted]			
14	[Redacted]			
15	Adnan Hasalami	Eksp. nr. [Redacted]	[Redacted]	
16	Ilin Gela	DRM - KUKES		
17	Mirvatë Kërshali	DRM - KUKES		
18				
19	Administratori			
20	Solmir Halilo			
21				
22				
23				
24				
25				

PALESHI
Tirana Import Export
TIRANA ALBANIA

Adnan Hasalami
Certifikatë Nr: 429

(Foto nga takimi)





REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT KUKËS

Nr. 67 Prot

Kukës, më 22/02/ 2019

DEGJESE ME PUBLIKUN

Në zbatim të detyrës të dhënë nga Drejtori i DRM-Kukës me autorizim përkatës me Nr 55 Prot Datë 18.02.2019, deleguar nga AKM-ja me date 12.02.2019, për pjesmarrjen në degjese me publikun të organizuar nga subjekti "PALUSHI" sh.p.k me aktivitet: Ndertim dhe funksionim i hec PALUSHI.

Me date 18.02.2019 ora 11⁰⁰, ne si specialiste te DRM-Kukës ishim te pranishem ne séancen degjimore me publikun të organizuar nga subjekti "PALUSHI" sh.p.k me aktivitet: Ndertim dhe funksionim i hec PALUSHI, Perroi i Bicajve, NJ.Q.V Bicaj, Bashkia Kukes, Qarku Kukes.

Seanca degjimore eshte zhvilluar ne ambient te hapur ne afersi te vendit ku do te ndertohet godina e hecit. Takimi filloi ne oren 11³⁰ deri ne oren 12⁰⁰ gjithsej 30 minuta.

Në këtë takim ishin të pranishëm:

- Përfaqesues te subjektit.
- Eksperti i Mjedisit
- Përfaqesues të DRM-së Kukës.
- Banorë te zones.

Administratori i NJ.Q.V Bicaj ka konfirmuar se banoret e pranishem jane banore te kesaj njesie vendore dhe ka vulosur formularin e presences.

Projekti i paraqitur ka te beje me ndertimin e Nje Heci per prodhimin e paster te energjise elektrike duke shfrytezuar ujrat e Perroit te Bicajt. Projekti i paraqitur fillon me vepren e marrjes te hecit ne kuoten +396 m mbi nivelin e detit dhe me nje lartesi 4.2 m dhe vazhdon me depo presioni ne kuoten +394.7 m mbi niveline detit, kanalin e derivacionit me diameter 1000 mm dhe gjatesi 2510 ml, dhe godina e hecit ne kuoten +304 m mbi nivelin e detit. Ku kapaciteti i projektuar eshte 1012 kw. Per ndertimin e nenobjekteve do te perdoren struktura beton arme, gure, rerc, zhavor, hekur, çakull etj, si dhe makineri e paisje specifike ne funksion te ketyre punimeve. Do te behet edhe lidhja me rrjetin elektrik te zones. E gjithe infrastruktura ne funksion te ketij projekti do te ndertohet ne shtratin e perroit si dhe do te kaloje poshte dy urave, ku njera ure eshte pjese e rruges nacionale Kukes-Peshkopi, ndorsa ura tjetere lidh fshatin Bushat me rrugen kryesore Kukes-Peshkopi si segmenti kryesor ne kete rajon.

Nder ndikimet negative kryesore ne toke mund te jene: shqetesim i shtreses se tokes per shkak te hapjes se punimeve, ngjeshjes se pjeshme te tokes nga levizja e mjeteve te punes dhe automjeteve te transportit, erozion minimal, vibracione si pasoje e gerrimeve, shkarkim minimale te gazeve nga automjetet, emetim zhurmash nga automjetet dhe nga mjetet e punes etj. Ne perfundim te aktivitetit do te rehabilitohet gjithë sipërfaqja e prekur nga ky projekt.

Te gjithë banoret e pranishem ishin dakort per realizimin e kettj projekti dhe nuk shprehen asnje kundërshtim ne lidhje me kete projekt.

Ne këtë degjese publike morën pjesë:

Ahmet	Palushi	Banor
Donald	Hoxha	Banor
Asllan	Nuhiallari	Banor
Besmir	Palushi	Banor
Luart	Nuhiallari	Banor
Krenar	Braha	Banor
Xhevdet	Shehu	Banor
Ajet	Shehu	Banor
Altin	Palushi	Banor
Luan	Cenaj	Banor
Agim	Hasalani	Ekspert mjedisi
Meriman	Palushi	Administratori i subjektit
Illir	Çela	Perfaqesues i DRM-se Kukës
Mirush	Kerxhaliu	Perfaqesues i DRM-se Kukës

Hartuan Raportin

Illir Çela

Mirush Kerxhaliu



Bashkëlidhur Foto nga degjesa me publikun:

PERISE
SHE
X





REPUBLIKA E SHQIPËRIE

MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT KUKËS

Nr. 55 Prot

Kukës, më datë 18.02.2019

AUTORIZIM

Në mbështetje të të Ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011, " Për Mbrojtjen e Mjedisit", ligjit nr. 10448, datë 14.07.2001 " Lejet e mjedisit", ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011 " Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 " Për kundravajtjet administrative" dhe të VKM-së Nr. 47, datë 29.01.2014, VKM-se nr. 247, datë 30.04.2014 " Pë përcaktimin e rregullave dhe kërkesave të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore", VKM –se 419 dt. 25.06.2014 kreu VI-pika 16 ;

AUTORIZOJ:

Specialistet e Monitorimit/Lejeve dhe VNM-së pranë Drejtorisë Rajonale të Mjedisit Kukës (DRM) të paisur me dokumentin identifikues,


1. z. Ilin Gela
2. z. Mirush Berxholiu
3. z. _____

Deleguar nga AKM – ja me date: 12.02.2019
Per pjesmarje ne "Dëgjese me publikum" në:

Subjekti : Palushi Sh. p.h.
me aktivitet: "Nolezim, olhe funksionim i HEC Palushi"
me adresë: Perroi Bicaj, pranë Shatit Bicaj dhe Nauge, Myq. V. Bicaj, Kukës
mbajtës i lejes: _____

Objekti i Inspektimit:

"Dëgjese" Ne Publikum.



Dëgim KP "Palushi" sh.p.k

1 message

Olkida Mersini <Olkida.Mersini@akm.gov.al>


To: arm kukes <armkukes@gmail.com>

Cc: "Edison Konomi@yahoo.com" <EdisonKonomi@yahoo.com>, Flamur Kapllani <Flamur.Kapllani@akm.gov.al>

"manushaqe.dogjani@gmail.com" <manushaqe.dogjani@gmail.com>, Evis Mellonashi <Evis.Mellonashi@akm.gov.al>

"Bujana Janica" <bujana_t@hotmail.com>

Tue, Feb 12, 2019 at 2:55 PM



Pershendetjet

Subjekti "Palushi" sh.p.k ka paraqitur kërkesën për "**Dëgjesë me Publikun**".

Nga data e aplikimit është plotësuar afati i publikimit në WEB dhe ky takim ju delegohet juve për pjesëmarrje.

Pas zhvillimit të dëgjesës, lutemi dërgoni një **Raport përmbledhës** i cili të përmbajë: datën, minutat e diskutimit si dhe vendimin përfundimtar të takimit.

Në web-in zyrtar akm.gov.al <<http://akm.gov.al>>/ publiku në vendmarrje, gjeni info rreth subjektit.

Faleminderit për bashkëpunimin.

Olkida Mersini

Specialiste Sektorit të VNM-së,

Drejtorja e Vlerësimit Mjedisor,

Agjencia Kombëtare e Mjedisit

<http://www.akm.gov.al>

Cel: +355 67 59 38 328

Informacioni i trasmetuar në përmbajtje të këtij mesazhi është i destinuar vetëm për individin ose për institucionin të cili i është nisur, mund të përmbajë materialo konfidencialo dhe / ose të privilegjuara vetëm për marrësin. Çdo rishikim, trasmetim, shpërndarje apo kryerje e ndonjë veprimi tjetër të ngjashëm me këto, nga personat apo nga subjekte të tjera të ndryshme nga marrësi i synuar, është i ndaluar. Nëse merri gabimisht këtë mesazh, ju lutem kontaktoni urgjentisht dërguesin e tij dhe fshini çdo material të trasmetuar në kompjuterin tuaj. Na nuk prenojme asnjë detyrim lidhur me dëmtimin apo humbjen e shkaktuar nga programe të dëmshme apo nga viruse , përveç rastit të neglizhencës së plotë, apo sjelljes së gabuar dhe të qëllimshme.



REPUBLIKA E SHqipërisë

MINISTRIA E TURIZMIT DHE Mjedisit
AGJENCIA KOMBËTARE E Mjedisit
DREJTORIA RAJONALE E Mjedisit KUKËS



Kukës më 13.02.2019

Drejtuar: Njesia Administrative BIR01

Kukës

Lënda: Njoftim per degjese me publikan.

Bashkëlidhur po ju dërgojm Njoftimin per degjese me publikun per subjektin "PALUSHI shpk. me objekt NDERTIM FUNKSIONIM HEC PALUSHI. Gjithashtu gjeni CD me dokumentat per subjektin.

Faleminderit për mirëkuptimin e bashkëpunimin!

DREJTORI
SHEMSI SHAFU

FORMULAR TIP II

DËGJESA ME PUBLIKUN PËR VENDODHIJEN E INSTALIMIT

NJOFTIM

Agjencia Kombëtare e Mjedisit/ ARM e deleguar, njofton se do të organizohet Dëgjesa publike/seanca dëgjimore ku ftohen të jenë pjesëmarrës dhe palët e interesuara, në lidhje me vendodhjen e aktivitetit.

- LLOJI I INSTALIMIT: NAËRTIM I HEC PALUSHI
- EMRI I PERSONIT FIZIK/JURIDIK: "PALUSHI" shpk K.12.20.2004R
- ADRESËN E VENDODHJES SË INSTALIMIT: N.Y.Q.V. BICAJ KUKËS.
- ADRESA ELEKTRONIKE E AKM-së: info@akm.gov.al, ku publiku i interesuar dërgon komente dhe sugjerime, lidhur me zhvillimin e aktivitetit.
- VENDI I TAKIMIT, TEL: BUSHTI BICAJ 0682588582
- DATA DHE ORA E DËGJESËS: DATE: 18.02.2019 ORA: 11.00
- Mbaj përgjegjësi për dorëzimin e njoftimit pranë NJQV-së përkatëse në 20 kopje CD/DVD

Ftohen të marrin pjesë në këtë takim:

- Përfaqësues nga AKM / ARM
- Përfaqësues nga NJQV
- Përfaqësues nga OJF, OJQ
- Përfaqësues nga shoqëria civile
- Përfaqësues të bizneseve përreth
- Përfaqësues nga media vizive dhe të shkruara lokale
- Banorë të zonës përreth




ZHVILLIMI I SEANCËS DËGJIMORE

Pjesëmarrësve në takim iu shpërndahet informacioni si më poshtë:

Vendi i zbatimit të projektit:
PERROI 1 BILAZI, NJËRU BICAZI, BASHKIA SHUKES
Aktiviteti:
PRODIMI I ENERGJISE ELEKTRIKE NGA NDERTIMI I HEC PALUSHI
Kapaciteti, teknologjia:
FORQIA 1012, TEKNOLOGJI BASHKLETONORE
Lëndët e para, energjia, uji që do të përdoren:
DO TE PËRDOREN LËNDËT E PARA PËR NDERTIMIN SI: ÇAPULL, KËRE ZHAVORR, ETJ. ENERGJIA POTENCIALE QE KËRKET NGA PERROI 1 BICAZI.
Kohëzgjatjen e punimeve dhe funksionimit:
KOHËZGJATJA E PUNIMEVE QËRUAN FUNKSIONIMI 49 UJËT
Mbetjet që do të gjenerohen, lloji dhe sasia e tyre:
MËTJET QË DO TE GJENEROHEN GJATE NDERTIMIT TE HEC PALUSHI JANE MËTJET NGA NDERTIMET (PËRFSHI DHËRA TE SËRHMARH PËR NDERTIMIN E OBJEKTEVE TE HEC-IT, DËJESA MËS MËDHE DO RIPËRDORET MËPËJESA E MËTËT DO VENDEPOZITOHT.
Ndikimet negative në shëndet e mjedis:
NDIKIMET NEGATIVE NESHËNDET NUK DO TE KËNË. NDIKIMET NEGATIVE NË MJEDIS DO TE JENË MINIMALE DËRUO ZBATUAR MASAT E PËRCAKTURA NË RAPORTIN E UNH-58
Masat që do të merren për reduktimin e tyre:
TE GJITHË MASAT QË DO TE MËRKËN GJATE ZBATIMIT TE PROJEKTIT JANE PARAGITUR NË RAPORTIN E UNH-58, KËTO MASA TE PARASHITUARA JANE DISKUTUAR DHE NË DEGTËSEM ME BANORËT E ZONËS.
Masat që do të merren për monitorimin e tyre:
GJATE FAZËS SË ZBATIMIT I GJITHË PROCESI DO TE MONITOROHET NGA INSTITUCIONET PËRKATËSE DHE DO TE RAPORTOHET NGA INVESTITORI PRANË AKR-SC ALBN-sc etj.

Mbahen shënime si më poshtë:

- Minutat e takimit të shoqëruara me foto
- Emrat e pjesëmarrësve
- Problemet e ugritura nga të pranishmit, pyetje, komente, sugjerime dhe konkluzionet e arritura gjatë kësaj mbledhje
- I gjithë takimi zbardhet nga përfaqësuesi i shoqërisë dhe i bashkangjitet dosjes së aplikimit



Morën pjesë në Dëgjuesën me Publikim si më poshtë, shoqëruar dhe me foto:

Nr	Emër, mbiemër, nënskrimi	Institucioni, statusi	Nr. i kartës së identitetit	Largësia e banesës nga objekti (shprehur nga hauorj)
1	Adn Pulaski	Biri i

17




Figure 1. Foto gjate degjeses me publikum per projektin "Nderim i Hec Pafushi"




Figure 2. Foto gjate degjeses me publikum per projektin "Nderim i Hec Pafushi"

Agim Hascalari
Bardha 1999



Figure 3 Foto gjate degjeses me publikun per projektin "Nderimi i Hec Palushit"



Figure 4 Foto gjate degjeses me publikun per projektin "Nderimi i Hec Palushit"

Agim Hasalami
Certifikate Nr: 429



Figure 5 Foto gjate degjeses me publikun per projektin "Nderimi i Hec Palushit"




Figure 6 Foto gjate degjeses me publikun per projektin "Nderimi i Hec Palushit"

Shenim:

Agim Hasalami
Certificate No: 429



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT MJEDISOR

Nr. 1678 Prot.

Tiranë, më: 28 . 03 . 2019

Nr. Identifikimi 272

Vendimi 16

**VENDIM
PËR VNM PARAPRAK**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisve e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore",

AKM-ja pas përfundimit të procedurës paraprake të VNM-së, vendosi që ky projekt nuk duhet t'i nënshtrohet procedurës së VNM-së thelluar për zhvilluesin me të dhënat si më poshtë:

Person juridik: "PALUSHI" sh.p.k.
Nr. NIPT-i: K12202004R
Adresa e selisë: Xhorxh Martin
Personi përgjegjës: Meriman Palushi

Për të zhvilluar projektin: "Ndërtimi i HEC Palushi "

Aplikimi është bërë referuar Ligjit Nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Shtojca II: Pika 3. Industria e energjisë (ë) Instalime për prodhimin e energjisë hidroelektrike;

Vendndodhja: Në pellgun ujëmbledhës të përroit të Bicajt, degë e lumit Drin i Zi, Bashkia Kukës, Qarku Kukës.

Të dhëna teknike

Fuqia totale e instaluar: 1012 kW

(Bashkangjitur vendimit, gjeni aneksin me hartën topografike dhe koordinatat metrike, ku tregohet vendodhja e objektit).

Bazuar në nenin 11 të Ligjit Nr. 10440, datë 7.7.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", më poshtë po listojmë:

Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi:

- Ky vendim mbështetet në Miratimin Paraprak nga MEI me Nr. 6748/3, datë 19.06.2018, "Për vazhdimin e procedurës për ndërtimin e burimit të ri gjenerues të energjisë" për ndërtimin e Hidrocentralit "Palushi", në pellgun ujëmbledhës të përroit të Bicajt, degë e lumit Drin i Zi, Bashkia Kukës, Qarku Kukës

Mendimi i institucioneve të konsultuara:

Drejtoritë Teknike të Ministrisë shprehen: që projekti nuk është e nevojshme t'i nënshtrohet procedurës së tholluar të VNM-së, por të mbahen parasysh sugjerimet e mëposhtme si:

- Ligji nr. 10431/2011, "Për mbrojtjen e mjedisit"
- Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" i ndryshuar;
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24. 06. 2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte";
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 229, datë 23. 04. 2014 "Për miratimin e rregullave jo të rrezikshme;
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 371, datë 11.06.2014 "Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme;
- Subjekti që do të transportojë apo transferojë mbetjet të jetë i pajisur me licencë të tipit III.2.B, si detyrim i nenit 57, të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" i ndryshuar;


Ajencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, shprehet: Sipërfaqja ku do të zhvillohet aktiviteti i subjektit Palushi ndodhet 200 m larg Zonës së Mbrojtur Korab Koritnik.

• Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:

Konsultimi me publikun: Morën pjesë përfaqësues nga komuniteti i zonës, përfaqësues nga Pushteti Vendor si dhe nga Drejtoria Rajonale e Mjedisit dhe përfaqësues nga studio mjedisore. Nuk pati ndonjë shqetësim nga komuniteti për zhvillimin e këtij aktiviteti. Në takim është prezantuar projekti, janë dëgjuar sugjerimet e pjesëmarrësve, të cilat do të merren parasysh nga ana e investitorëve, gjatë kohës së shfrytëzimit. Nga ana e investitoreve iu siguroa të pranishmëve që do të merren të gjitha masat për eliminimin e ndikimeve negative në mjedis.

3. Përsëritjen, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmanjur, reduktuar e, nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme:
- 3.1 Ky aktivitet të zhvillohet në përputhje të plotë me Kontratën Konçensionare / Miratimin Paraprak, Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, Leje për Shfrytëzimin e ujit, të miratuara nga organet kompetente (KKT / Bashki / Njësi Administrative apo Institucioneve të tjera) sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- 3.2 Në rast se kjo sipërfaqe prek fond pyjor, subjekti duhet të bëjë kërkesë pranë institucioneve përkatëse për heqje nga fond pyjor.
- 3.3 Subjekti të kryejë aktivitetin vetëm brenda kordinatave të dhëna në relacionin teknik.
- 3.4 Masa e dheut e gjeneruar nga operacionet e gërmimit gjatë fazës së ngritjes së digës të përdoren për sistemin e shtratit të rrjedhes ujqore.
- 3.5 Në periudhën e verës, për shkak të kohës së thatë, të mos të ketë punime.

- 3.6 Të mos krijohen pengesa në kanalet vaditëse përgjatë rrjedhës së lumit.
- 3.7 Në asnjë rast nuk duhet të krijohen pengesa në qarkullimin e njerëzve, kafshëve dhe automjeteve, përgjatë shtrirjes së projektit.
- 3.8 Në rast se gjatë punimeve do të ketë probleme sa më sipër, subjekti të lajmërojë menjëherë DRM / AKM.
- 3.9 Të sistemohet shtrati i burimit ujor me dherat dhe inertet që do të gjenerohen nga gërmimi për shtratin e tij.
- 3.10 Të forcohen brigjet e rrjedhës ujore duke mbjellë fidanë të rinj në brigjet e saj paralelisht me ndërtimin e veprës.
- 3.11 Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyre periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikanteve dhe hidrokarbureve në mjedis, emetimin e gazeve dhe zhurmave të tepërta të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve.
- 3.12 Ndërtimi i HEC-it të mos dëmtojë vepra dhe infrastrukturën e ujijes, kullimit dhe objekteve të tjera në afërsi, barriera mbrojtëse, tubacione ujësjellësi, kanale etj.
- 3.13 Për asnjë arsye të mos çënohet aktiviteti i përditshëm bujqësor i banorëve përreth, duke minimizuar kështu impaktin social.
- 3.14 Të bëhet kujdes me ruajtjen e ekosistemit ujor, duke mos çënuar në asnjë mënyrë segmentet ujore.
- 3.15 Të respektohen të gjitha kushtet teknike dhe standartet, për operimin e punës brenda subjektit sipas relacionit të përshkruar në VNM.
- 3.16 Niveli i zhurmave gjatë procesit të ndërtimit të jetë brenda normave të lejuara dhe të punohet në orare kur shqetësimi i banorëve dhe zonave përreth të jetë me ndikim sa më të ulët (jo herët në mëngjes dhe jo vonë në mbrëmje).
- 3.17 Të merren masat teknike dhe organizative për zbutjen e ndikimeve në mjedis të gjeneruara nga operacionet e gërmimit dhe gjenerimit të dherave.
- 3.18 Të bëhet rrethimi i zonës ku do të realizohen punimet, për të shmangur hyrjet e pautorizuara të individëve dhe faunës së zonës përreth.
- 3.19 Operacionet për zbatimin e projektit (ndërtimi) të përdorin sa më shumë të jetë e mundur infrastrukturën egzistuese të transportit (rrugën dhe rrjetet egzistuese).
- 3.20 Subjekti të kujdeset për menaxhimi e mbetjeve inerte dhe të tjera, duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimit e caktura nga njësia vendore sipas legjislacionit në fuqi.
- 3.21 Të parashikohen dhe merren masa për parandalimin dhe kontrollin e ndotjeve në tokë gjatë fazës së instalimit të pajisjeve teknologjike për ndërtimin e veprave, si derdhje lëndësh ndotëse, vajra lubrifikues, graso, karburante etj.
- 3.22 Të përdoren mjete të kolauduara për ndërtimin dhe zbatimin e projektit, me qëllim evitimin e ndotjeve të mundshme si pasojë e dëmtimit apo avarie të mundshme.
- 3.23 Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyre periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikanteve dhe hidrokarbureve në mjedis emetimin e gazeve dhe zhurmave të tepërta të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve;
- 3.24 Parkimi i mjeteve dhe ruajtja e makinerive të bëhet vetëm brenda sipërfaqjes së kampeve të ndërtimit dhe në vendin e përcaktuar;
- 3.25 Transporti i materialit inert të bëhet me mjete të pastra sidomos nga balta (të pastrohen gomat para daljes në rrugë të asfaltuar), gjatë transportit mjeteve transportuese të mbulohen me mbulesa të cilat parandalojnë rrjedhjet e materialit në rrugë dhe emetimin e pluhrave;
- 3.26 Shërbimi i automjeteve, magazinimi ose mbajtja e mjeteve ndihmëse të punës si pjesë këmbimi për automjete, lubrifikante, goma etj. të bëhen në vende të tilla që të evitohen dhe kontrollojnë ndotjen në mjedis;



- 3.27 Të merren masa për të parandaluar rëniet e zjarrit gjatë realizimit të punimeve në terren (shpime, cigare etj) dhe të sigurohen mjetet e nevojshme të ndërhyrjes në rast të rënies së zjarrit (zjarrfikse të lëvizshme, bombula me shkumë, etj);
- 3.28 Të funksionojnë rregullisht të gjithë agregatat teknologjike të mbrojtjes së mjedisit;
- 3.29 Subjekti të ndjek me përpikmëri projektin teknik për të evituar erozionin e tokës, me qëllim ruajtjen e cilësisë së ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore;
- 3.30 Operacionet e ndërtimit të veprës të shmangin në maksimum dëmtimin e tokës dhe pengojnë zhvillimin e proceseve të degradimit mjedisor, si erozionin etj;
- 3.31 Për parandalimin e rrjedhjes së sterileve në drejtim të rrugës, përrrenjve apo proskave të zonës, të bëhet depozitimi i tyre duke ndërtuar mure gabioni, blloqe gurësh të rregullt ose instalimi i rjetave metalike në shpatet e malit, si dhe sisteminimi i masave të dheut që dalin nga ndërtimi i veprës, me qëllim ruajtjen e cilësisë së ujrave nga ndotjet e mundshme dhe kompaktësinë e formacioneve gjeologjike të zonës.
- 3.32 Masat e dheut që gjenerohen nga punimet ndërtimore duhet të mbahen nën kontroll dhe të mos lejohen të rrëshqasin dhe sedimentojnë në rrjedhat ujore në zonën e ndërtimit, përfshirë edhe shtratin e ujëmbledhësit (rrisin turbullirën, dëmtojnë gjendjen natyrale të lumit, etj) dhe të sistemohen në vendepozitime të paracaktuara në bashkëpunim me qeverisjen vendore. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte".
- 3.33 Të ruhet Qca sipas kërkesave në Nenin 39, të Ligjit nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", gjatë fazës së funksionimit.
- 3.34 Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë kantlerit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore.
- 3.35 Në rast aksidentesh ose defektesh teknologjike që shkaktojnë ndotje të mjedisit, subjekti menjëherë duhet të jap informacion në DRM-në e qarkut përkatës dhe AKM-në, të cilat bëjnë të mundur njoftimin e popullatës që preket nga ky aksident.
- 3.36 Para fillimit të veprimtarisë të trajnohen të gjithë punëtorët e subjektit si dhe të njihen me temat e Vendimit dhe pasojat e mos-zbatimit të tyre në mjedis dhe në marrëdhëniet e subjektit me organin e dhënies së Vendimit që të evitojnë dhe kontrollojnë ndotjen në mjedis.
- 3.37 Me qëllim mbrojtjen e ekosistemit dhe natyralitetit të përroit në segmentin ku do ndërtohet hidrocentrali shoqëria të lejojë rrjedhjen në shtratin egzistues të lumit dhe burimeve ujore sasinë e ujit të përcaktuar nga organet kompetente.
- 3.38 Të dimensionohen dhe ndërtohen veprat e shuarjes së energjisë së rrymës ujore pas daljes nga kanali me deviacion, me qëllim mbrojtjen e mjedisit dhe minimizimin e erozionit ujor.
- 3.39 Përgjatë gjithë perimetrit dhe sheshit ku kryhet aktiviteti të mbillen kurorë pemësh të larta në mënyrë që të reduktohet impakti negativ në pamjen e zonës. Pemët të jenë të llojit të mjedisit ku do mbillen.
- 3.40 Për të ruajtur informacionin mbi zbatimin e kushteve të Vendimit, gjatë fazës së ndërtimit të veprës subjekti duhet të përpilojë një regjistrë të veçantë për monitorimin e cilësisë së tokës, ajërimit dhe ujërave, si dhe prurjen e rrjedhës ujore gjatë 12 (dymbëdhjetë) muajve, të cilin duhet ta vëre në dispozicion të institucioneve shtetërore si dhe të interesuarve të tjerë për përmbajtjen e këtij regjistri.
- 3.41 Të pastrohet menjëherë çdo rast ndotje e mjedisit brenda dhe jashtë objektit si pasojë e aktivitetit.
- 3.42 Të bëhet pajisja me tabela informuese dhe drejtuese për shmangien e rreziqeve dhe pasojave me ndikim në mjedis brenda zonës së veprave.

- 3.43 Të hartohet Plani i Përballimit të Emergjencave i plotë dhe i detajuar, para vendosjes në funksionim të veprës dhe të raportohet pranë AKM-së për përbajtjen e këtij plani.
- 3.44 Të trajtohen të gjithë punonjësit dhe të njihen me termat e Planit të Përballimit të Emergjencave.
- 3.45 Përcaktimi i hedhjes së dherave në vende të zhveshura, të eroduara, gropa, që rezultojnë gjatë punimeve dhe sheshimi e nivelimi i tyre, përgatitur për mbjellje.
- 3.46 Sipërfaqet e eroduara, të zhveshura dhe të shpyllëzuara, mundësisht të mbushen me dherra apo mbetje inerte që gjenerohen gjatë gërmimeve dhe të mbillen me bimësi barshitore, shkurre dhe pemë pyjore të llojeve autoktone.
- 3.47 Të kryhen punime hidroteknike për të minimizuar fenomenin e erozionit si prita me mure guri të thatë, gardhe dhe mbjellje me pemë pyjore.
- 3.48 Gjatë periudhës së ndërtimit të HEC-ve, të përdoren mjete e makineri që plotësojnë standardet e BE-së.
- 3.49 Të evitohet turbullimi i ujit që ndikon drejtëpërdrejtë në ciklet biologjike.
- 3.50 Për të ulur ndikimin negativ të peisazhit nga ndërtimi i HEC-ve, të kryhen mbjellje të pemëve me kurora të gjera dhe të larta.
- 3.51 Të lihet pjesë e rrjedhjes së lirë të ujit për të siguruar vazhdimësinë e faunës ujore.

Gjatë fazës së rehabilitimit:

- 3.52 Në përfundim të aktivitetit ndërtimor të hidrocentralit të rehabilitohet sipërfaqja e ndikuar nga ndërtimi i tij (rrugë, sheshe për depozitim materiale, kanali i derivacionit).
- 3.53 Para fillimit të operacioneve të ndërtimit të hartohet plani rehabilitimit mjedisor i plotë dhe i detajuar i rehabilitimit të bimësisë dhe territorit ku do të kryen punimet për realizimin e projektit.
- 3.54 Të sistemohet sipërfaqja e shesheve të veprave dhe brigjeve të përroit dhe të bëhet mbjellja e pemëve dhe bimësisë autoktone.
- 3.55 Duhet të raportojë periodikisht pranë AKM - së për ecurinë e punimeve të rehabilitimit mjedisor.
- 3.56 Plani i rehabilitimit mjedisor përfshin zonat ku do të realizohen punime rehabilituese, volumn dhe llojin e punimeve, përfshi dhe afatet kohore të realizimit të punimeve të rehabilitimit.
- 3.57 Detyrime të monitorimit dhe raportimit mjedisor gjatë fazës së ndërtimit të veprës:
- 3.58 Monitorimi është procesi i vëzhgimit dhe mbledhjes së të dhënave në mënyrë periodike ose të vazhdueshme mbi fenomenet natyrore që zhvillohen në objekt, si pasojë e ndërtimit të veprës.
- 3.59 Vetmonitorimi i veprimtarisë realizohet në bazë të programit individual të monitorimit i cili duhet të trajtojë çështjet e mëposhtme:
- 3.60 Monitorimi i ndotjes akustike si pasojë e punimeve të ndërtimit të veprës
- 3.61 Monitorimi i ndikimeve të veprimtarisë në mjedisin përreth dhe elementë të tij.
- 3.62 Monitorimi i mënyrës së zbatimit të kushteve të Vendimit
- 3.63 Monitorimi i ecurisë së realizimit të masave të rehabilitimit dhe efektivitetit të tyre.
- 3.64 Monitorimi i rrjedhës natyrore të burimit ujor që përdor hidrocentrali, prurjen ekologjike, si edhe zhvillimin e gjendjen e biodiversitetit.

Sanksionet e mundshme:

- 3.65 Për mos respektimin e kushteve të Vendimit dhe të legjislacionit mjedisor ka sanksione ligjore:
- 3.66 Ndëshkimi administrativ dhe penali i subjektit që nuk zbaton kushtet e Vendimit

3.67 Përfundimi i aktivitetit për një afat kohorë.

Raportimi i të dhënave mjedisore:


- 3.68 Në zbatim të kërkesave ligjore subjekti duhet të bëjë vlerësimin mjedisor periodik të veprës gjatë fazës së instalimit;
- 3.69 Për të mbajtur informacionin mbi monitorimin, zbatimin e kushteve të Vendimit subjekti duhet të përpilojë një regjistër të veçantë.
- 3.70 Të dhënat e vetëmonitorimit dhe të zbatimit të kushteve të Vendimit duhet ta vërë në dispozicion të institucioneve shtetërore, si dhe të interesuarve të tjerë.
- 3.71 Për çdo ndryshim të planifikuar në teknologji, operacione të paparashikuara dhe deklaruara në raportin e paraprak të VNM-së, të njoftohet menjëherë DRM-në e qarkut përkatës.
- 3.72 Të njoftohet DRM-ja e qarkut përkatës, në çdo kohë, për aksidentet ose emergjencat me ndikim negativ në mjedis.
- 3.73 Gjatë fazës së ndërtimit, për të gjitha termat e mësipërme të Vendimit, subjekti është i detyruar të dorëzojë pranë AKM-se një relacion shkresorë në mënyrë periodike për mënyrën e zbatimit të kushteve (çdo 6-muaj).
- 3.74 Në përfundim të punimeve subjekti të dorëzojë pranë AKM-së, një relacion ku të pasqyrohen edhe me foto, të gjitha punimet rehabilituese të territorit përreth.
- 3.75 Pavarësisht kushteve të Vendimit, veprimtaria është e detyruar të zbatojë kërkesat e legjislacionit mjedisor në fuqi, Ligji Nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit".

Afati kohor i vlefshmërisë së Vendimit:

- 3.76 Në bazë të Ligjit Nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" të ndryshuar, Neni 20, Pika 5. Nëse veprimtaria nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të vendimit për VNM-në, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para.

Në bazë të udhëzimit të përbashkët të MM dhe Mf nr. 7938, datë 17.7.2014 "Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së, ky subjekt ka kryer pagesën 30.000 lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM I AKM.



Planvendosja e sipërfaqes së objektit

Koordinatat e nenobjekteve të Hee Palushi

HEE PALUSHI	X	Y
Vepra e ngrjet	534630	4651324
Baseni i presionit	534594	4651364
Godina e centralit	533697	4653488

